

# **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

## **DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**

**P.nr. 322/09 (P.nr.45/13)**

**18 Tetor 2013**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS- Departamenti i Krimeve të Rënda, e përbëre nga Gjyqtari e EULEX-it Arkadiusz Sedek, Kryetar i Trupit Gjykues, Nora Bllaca, gjyqtare, si dhe Willem Brower, Gjyqtare i EULEX-it. Si anëtare të trupit gjykues, të ndihmuar nga Natasa Malesevic- procesmbajtëse , në rastin kundër :**

**H.K., i akuzuar për Vrasje të Rende sipas Nenit 147 (5) dhe (9) të Kodit Penal të Kosovës (KPK),**

Pas mbajtjes se nënte (9) seancave të hapura gjyqësore, në praninë e prokurorit të shtetit Ilaz Beqiri nga Zyra e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, avokatit mbrojtës Mustafë Kastrati, palës se dëmtuar Ragip Salihu, dhe

Pas pleqërimit dhe votimit të trupit gjykues më 18 Tetor 2013, ne pajtim me Nenin 392 të KPPK-së nxjerr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**H.K., ( ne tekstin e mëtejme “ i pandehuri” ):**

- **SHPALLET FAJTOR për Vrasje të Rënde në kundërshtim me Nenin 147 (5) dhe (9) të KPK-së sepse më 17 Shkurt 2009, ne mes të orës 15:30 dhe 17:00 në një mal në fshatin Z., Komuna e Prishtinës, duke vepruar ne mënyre të pamëshirshme dhe të dhunshme për motive të ulëta, vazhdimisht ka qëlluar V.S., në kokë dhe trup me një objekt të rënde duke i shkaktuar asaj lëndime të rënda trupore, pra duke shkaktuar plage shqyese dhe shqyese, hematoma ne pjese të ndryshme trupore, thyerje ne kafke si dhe lëndime në tru duke e privuar viktimën nga jeta e saj;**
- **DËNOHET me njëzet e dy vite (22) burg. Periudha kohore e kaluar në paraburgim qysh nga 19 Shkurti 2009 i llogaritet në dënimin e dhënë.**
- **URHDËROHET të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shume prej 100 Eurove si shume paushallë.**

**Palët e dëmtuara mund të iniciojnë procedurë civile për kërkim kompensimi nga i pandehuri.**

## ARSYETIM

|   |    |
|---|----|
| Sfondi procedural dhe faktik.....   | 3  |
| Juridiksioni i gjykatës .....   | 5  |
| Ligji procedural i aplikueshëm .....  | 5  |
| Provueshmëria e Provave.....  | 6  |
| Provat e Administruara gjate Shqyrtimit Kryesor .....   | 9  |
| Vlerësimi i provave.....  | 11 |
| <i>Deklarata e të pandehurit para policisë, Prokurorit dhe gjykatës .....</i>   | 11 |
| <i>Deklarata e dëshmitarit H.T., e dhënë para policisë dhe prokurorisë .....</i>  | 15 |
| <i>Deklarata e dëshmitares Z.M-Z., e dhënë para gjykatës.....</i>   | 17 |
| <i>Deklaratat e dëshmitarit R.S., para policisë, prokurorit dhe gjykatës .....</i>  | 17 |
| <i>Deklaratat e dëshmitarit Sh.S., para policisë, prokurorisë dhe gjykatës .....</i>  | 17 |
| <i>Deklaratat e dëshmitarit V.S., para policisë, prokurorisë dhe gjykatës.....</i>  | 18 |
| <i>Deklaratat e oficerëve të policisë dhe zyrtarëve të tjerë .....</i>  | 18 |
| <i>Deklarata e dëshmitarit U.K., e dhënë para gjykatës .....</i>  | 18 |
| <i>Deklarata e dëshmitares F.K., e dhënë para gjykatës .....</i>  | 19 |
| <i>Deklarata e dëshmitares B.K., e dhënë para gjykatës .....</i>  | 19 |
| <i>Mesazhet telefonike SMS.....</i>   | 20 |
| <i>Regjistrimi i thirrjeve telefonike.....</i>  | 20 |
| <i>Raportet e ekspertizës ADN.....</i>  | 20 |
| <i>Raporti mbi ekspertizën e autopsisë.....</i>   | 21 |
| <i>Raporti i ekspertizës lidhur me gjendjen mendore të të pandehurit .....</i>  | 22 |
| <i>Dokumentacioni mjekësor për gatitur në Qendrën Korrektuese në Dubravë në kohën kur i pandehuri ishte në paraburgim .....</i> | 22 |
| <i>Përgjigje nga Policia e Kosovës më datë 24 janar 2013 .....</i>  | 23 |

|  |    |
|--|----|
| Gjendja faktike e vërtetuar.....               | 23 |
| Kualifikimi juridik i veprës së ngarkuar ..... | 25 |
| Dënimi: .....                                  | 25 |
| Shpenzimet e Procedurës Penale .....           | 26 |
| Kërkesa pasurore juridike .....                | 27 |
| Konkludimi: .....                              | 27 |

## I. Sfondi procedural dhe faktik

1. Më 18 Shkurt 2009, rreth orës 12:00, Policia e Kosovës morri një informatë nga një qytetar , **M.Sh.**, se trupi i vdekur i një femre ishte gjetur afër fshatit **Z.**, Komuna e Prishtinës. Viktima kishte shenja të qarta dhune. Policet e Kosovës dhe Prokurori i çështjes shkuan ne vendin e ngjarjes. Ekipi i mjekësisë ligjore mblodhi provat qe u gjetën ne vendin e ngjarjes, kurse trupi i pajete i viktimës u bart në morg dhe pastaj u bë edhe autopsia.
2. Me 19 Shkurt 2009, herët ne mëngjes, **R.S.**, dhe **Sh.S.**, babai respektivisht axha i viktimës, vizituan morgun Prishtinës. Ata e identifikuan trupin e pajetë si i **V.S.**
3. Me 19 Shkurt 2009, Prokurori Publik në Prishtinë, duke vepruar në bazë të kërkesës nga Policia e Kosovës, lëshoi një urdhër për PTK-Vala qe të i jap prokurorit listingun dhe mesazhet telefonike për numrat e telefonit: **A** dhe **B**, që të dy ne posedim dhe pronësi të viktimës. Përmbajtja e mesazheve SMS zbuloi komunikim të shpeshte në mes të viktimës dhe numrave të telefonave qe i përkisnin të pandehurit.
4. Në të njëjtën datë ( 19 Shkurt 2009) Policia e Kosovës intervistoi pronaren e shtëpisë ku **V.S.**, punonte si pastruese. Ajo tha se njëri nga punëtorët e saj e kishte parë viktimën duke biseduar me një person mashkull në ditën kritike. Punëtori i pronarit të shtëpisë **H.T.**, i tha Policisë së Kosovës, se ai e pa viktimën rreth orës 15:30 duke pasur një bisede të nxehte me një mashkull afër shtëpisë ku ajo punonte si pastruese. Ky dëshmitar deklaroi poashtu se e pa prape viktimën dhe personin e njëjte mashkull pak kohe më vonë në një kafe/restorant në rr.**I.K.**, duke pirë kafe dhe me pastaj duke dalë nga kafeja/restoranti se bashku.
5. Me 19 Shkurt 2009 , rreth orës 15:00, Policia e Kosovës arrestoi të pandehurin derisa ai ishte duke vozitur veturën e tij ne rrugët e fshatit **Zh.**, Komuna e Vushtrrisë. Pas arrestimit ai u rrëfye se ai ishte kryesi i veprës penale, pra vrasësi i viktimës. I pandehuri

informoi policinë se pasi që kreu vrasjen ai e hodhi jaknën si dhe çantën e viktimës dhe armen me te cilën e kishte kryer vrasjen, afër vendit të ngjarjes. Në të njëjtën ditë, pasi Policia e Kosovës kishte marrë këtë informatë kishte bërë edhe një kërkim në vendin e ngjarjes. Megjithatë, Policia e Kosovës gjeti vetëm jaknën e viktimës atë ditë. Pasi që atë ishte duke reshur borë shumë e madhe Policia e Kosovës u desh të ndalë operacionin e kërkimit tek vendi i ngjarjes.

6. Më 20 Shkurt 2009 ishte bërë ekzaminimi e veturës se të pandehurit. Tri mostra ( E#9.1, E#9.2 dhe E#9.3) të njollave të gjakut të dyshuar ishin marrë nga vetura dhe ishin dërguar për analizë ADN.
7. Më 27 Shkurt 2009 kallëzimi penal ishte bërë nga Policia e Kosovës tek Prokuroria e Qarkut të Prishtinës. Kallëzimi Penal ishte regjistruar me nr. Prokurori Publik: nr. 130-2/2009. Kallëzimi penal ngarkoi të pandehurin me Vrasje të Rënde.
8. Më 9 Mars 2009, pasi që ishte shkrirë bora, Policia e Kosovës shkoi tek vendi i ngjarjes për një hetim shtese. Ata filluan të kërkojnë armën e përdorur në vrasje si dhe kuletën e viktimës. Ata gjeten një shufër metali prej 50 cm ne afërsi të vendit ku ishte gjetur trupi.
9. Me 16 Qershor 2009 Prokurori Publik i Qarkut në Prishtine ngiti aktakuzën PP: nr. 130-2/2009 duke akuzuar të pandehurin me Vrasje të Rënde sipas Nenit 147, par. 5 dhe 9 të KPK-së.
10. Me 9 Shtator 2009 seanca për konfirmimin e aktakuzës ishte mbajtur. Gjate seancës nuk ishte e mundur që gjyqtari të vendos komunikim me të pandehurin. Ky i fundit bënte disa gjestikulacione dhe veprime të çuditshme duke sugjeruar se i pandehuri ishte mentalisht i paaftë. Prokurori i çështjes propozoi që të behet një ekspertize psikiatrike dhe psikologjike në mënyre që të vërtetohet nëse i pandehuri ishte në gjendje të marre pjese në gjykim. Gjyqtari konfirmues urdhëroi Kliniken Universitare të Kosovës të kryej ekspertizën psikiatrike/psikologjike.
11. Me 11 Dhjetor 2009 Klinika Universitare e Kosovës i dërgoi gjykatës raportin e ekspertizës (nr.469). Ekspertiza konkludonte se i pandehuri nuk kishte paaftësi mendore dhe se ishte i afte të dalë në gjyq.
12. Më 18 Janar 2010 Gjykata e Qarkut në Prishtine lëshoi aktvendimin e saj KA. Nr. 294/09 duke konfirmuar aktakuzën në tërësi.
13. Me 7 Maj 2010 ishte mbajtur seanca e parë dëgjimore e shqyrtimit kryesor. Më pas, tetë seanca tjera të shqyrtimit kryesor ishin mbajtur, e fundit me datën 27 Shkurt 2013.
14. Me 26 Gusht 2013, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, duke vepruar sipas kërkesës se avokatit mbrojtës të të pandehurit, vendosi që tu caktojë lënden Gjyqtareve të EULEX-it, Njesisë Mobile.

15. Me 9 Shtator 2013, ishte mbajtur seanca e parë e shqyrtimit kryesor para kolegjit të përberë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar vendor. Nuk kishte asnjë kundërshtim nga asnjëra pale mbi përbërjen e trupit gjykues. Trupi gjykues vendosi të rifilloj gjykimin nga fillimi dhe të ekzaminoj të gjitha provat nga fillimi pasi që përbërja e trupit gjykues kishte ndërruar si dhe shqyrtimi kryesor ishte shtyre për më tepër se tre muaj. Më pas, seancat e shqyrtimit kryesor ishin mbajtur me 17, 18, 19, 20, 30 Shtator 2013 dhe 4, 17, dhe 18 Tetor 2013.
16. Me 18 tetor 2013 aktgjykimi i trupit gjykues ishte shpallur dhe i pandehuri u shpall fajtor siç ishte akuzuar dhe u dënua si ne dispozitiv.

## **II. Juridiksioni i gjykatës**

17. Me 26 Gusht 2013 Kryetari i Asamblesë se Gjyqtareve të EULEX-it lëshoi një vendim mbi caktimin e rastit tek Gjyqtaret e Njësisë Mobile të EULEX-it në Prishtinë. Ky vendim ishte lëshuar në pajtim me Nenin 3 të Ligjit 03/L-53 mbi Juridiksion, Përzgjedhjen e rasteve dhe Caktimin e Lëndëve tek Gjyqtaret dhe Prokurorët e EULEX-it në Kosovë. Gjyqtarja e Kosovës u caktua si anëtare e Trupit Gjykues sipas vendimit të Kryetarit të Gjykatës Themelore të Prishtinës.
18. Kjo gjykate ka juridiksion territorial si dhe mbi çështjen e kësaj lende në pajtim me Nenet 9,11 dhe 15 të Ligjit Nr. 03/L-199 mbi Gjykatat.

## **III. Ligji procedural i aplikueshëm**

19. Gjykata vendosi të i kryej procedurat në pajtim me dispozitat e Kodit të vjetër të Procedurës Penale të Kosovës (2004). Vendimi që te procedohet sipas KPPK-se së vjetër ishte bazuar në Mendimin Ligjor të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. 56/2013 te datës 23 Janar 2013. Pika 2 e këtij mendimi ligjor thotë:

*“ Ne procedurat penale të nisura para hyrjes ne fuqi ( 1 Janar 2013) të Kodit të tanishëm , për te cilin shqyrtimi kryesor veçse ka filluar, por nuk ka përfunduar ose ka përfunduar por është dërguar mbrapsht për rigjykim ne kuptim të mjeteve ligjore të zakonshme apo jashtë-zakonshme, dispozitat e Kodit të vjetër duhet të aplikohen mutatis mutandis deri sa vendimi te merr formën e prere. Trupi gjykues ne këtë shkalle do të jete i përbëre nga gjyqtare profesional sepse nuk ka me dispozita ligjore mbi gjyqtaret porotë në ligjet në Kosovë” .*

20. Kjo gjykate ndan të njëjtin mendim me Gjykatën Supreme të Kosovës. Shqyrtimi Kryesor në këtë çështje filloi në 2009, pra dispozitat e Kodit të vjetër të Procedurës Penale të Kosovës janë të zbatueshme.

#### IV. Provueshmëria e Provave

21. Gjate zhvillimit të shqyrtimit kryesor çështja e provueshmërisë se provave ishte ngritur nga ana e avokatit mbrojtës të pandehurit. Me saktësisht, avokati mbrojtës pretendonte se deklarata e të pandehurit e dhëne para Policisë së Kosovës me 19 Shkurt 2009 ishte e papranueshme pasi qe kjo deklaratë ishte dhëne nën shtrëngim me dhunë.
22. Në mënyre qe faktet në këtë çështje të vërtetohen siç duhet, duke vepruar sipas kërkesës se avokatit mbrojtës, gjykata thirri ish-avokaten **Z.M-Z.** Ajo dha dëshmi para gjyqit me 19 Shtator 2013. Dëshmitarja deklaroi se ishte e pranishme nga fillimi deri ne përfundim të intervistës me të dyshuarin. Ajo deklaroi se e kishte paralajmëruar të pandehurin për pasojat e dëshmisë se tij. Me tutje, ajo deklaroi se ajo dhe i pandehuri e lexuan deklaratën e kontestuar dhe me pastaj qe të dy e nënshkruan atë pa ndonjë vërejtje. Znj. **Z.M-Z** dëshmoi në lidhje me rrethanat nën të cilat i pandehuri kishte dhënë deklaratën e tij. Ajo nuk u pyet për asnjë informatë informate qe ajo mund ta kishte marrë nga klienti i saj.
23. Më 7 Tetor 2013 gjykata pranoi dokumentet mjekësore të të pandehurit nga Qendra e Paraburgimit në Lipjan, më specifikisht raportin mjekësor që është përgatitur në kohën kur i pandehuri ishte paraburgosur për herë të parë në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan. Këto dokumente tregojnë se kontrolla mjekësore e të pandehurit ishte bërë me datën 21 Shkurt 2009 (një ditë pasi që i pandehuri ishte paraburgosur). Sipas këtij dokumenti asnjë shenjë dhune nuk është gjetur në trupin e të pandehurit.
24. Duke pas parasysh që i pandehuri dha deklaratën e tij me datën 19 Shkurt 2009 vullnetarisht, dhe se atij i ishte dhënë mundësia të konsultohet me avokatin e tij mbrojtës si dhe ai ishte paralajmëruar për pasojat ligjore të deklaratës se tij, gjykata konstaton se deklarata është marrë në përputhje me Nenet nga 229 deri 236 të KPPK-së. Prandaj, ne pajtim me Nenin 156 të KPPK-se deklarata e të pandehurit e dhënë para Policisë se Kosovës me 19 Shkurt 2009 është prove e pranueshme.
25. Më tutje, avokati mbrojtës i propozoi Gjykatës ta shpallë deklaratat e dëshmitarit **H.T.**, dhe **N.G.**, të dhëna para policisë më 17 Mars 2009, respektivisht 19 Mars 2009 si prova të papranueshme. Mbrojtja argumenton se procedura e identifikimit e bere nga Policia e Kosovës kur u morën ne pyetje **H.T.**, dhe **N.G.**, ishte ne shkelje të Nenit 254 të KPPK-së. Sipas mbrojtjes, ligji parasheh pjesëmarrjen e avokatit mbrojtës të të pandehurit ne kurdo që behet identifikimi.
26. Gjykata e gjen këtë pretendim si të pa-bazë. Procedura e identifikimit të personave rregullohet me Nenin 255 të KPPK-së. Gjuha përkatëse e këtij neni është si në vijim:

## **7. IDENTIFIKIMI I PERSONAVE DHE OBJEKTEVE**

### **Neni 255**

- (1) Kur ekziston nevoja qe të konstatohet nëse dëshmitari mund ta njeh një person apo një objekt , ky dëshmitar duhet që se pari të jep përshkrim , dhe të bëjë me dije tiparet dalluese këtij personi apo objekti.*
- (2) Dëshmitarit pastaj duhet te i tregohen personi me personat e tjerë te panjohur për dëshmitarin, ose fotografitë e tyre, apo sendi me sende të tjera te llojit të njëjtte ose fotografitë e tyre.*
- (3) Dëshmitarit i behet me dije se nuk detyrohet të zgjedhe personin ose sendin apo ndonjë fotografi dhe se është po aq e rëndësishme për te treguar se nuk e njeh personin, sendin ose fotografinë ashtu sikur se te thoshte se e njeh.*

Gjykata vëren se Policia e Kosovës ka vepruar ne pajtim të plotë me Nenin e lartpërmendur. Fillimisht dëshmitaret kane dhëne përshkrimin e personit/te dyshuarit ashtu siç kërkohet nga paragrafi 1 i Nenit 255. Policia e Kosovës ka informuar dëshmitarët qe ata nuk ishin nen ndonjë detyrim për të zgjedhur ndonjë nga personat ne rreshtin e fotografive, por qe te dy dëshmitaret kanë zgjedhur një fotografi. Për me tepër procesverbali është nënshkruar në mënyrë të rregullt nga polici dhe nga dëshmitaret. Pretendimet e avokatit mbrojtës se Neni 244 duhet të aplikohet ne këto rrethana është i gabuar, sepse ky nen udhëheq procedurën e inspektimit dhe ri-konstruimit të vendit të ngjarjes. Këto dy procedura janë plotësisht te ndryshme nga procedura e identifikimit të sendeve dhe personave që parashihen nga Neni 255 i KPPK-së.

27. Prandaj gjykata konstaton se deklaratat e **H.T.**, dhe **N.G.**, të dhëna para policisë me 17 Mars 2009, respektivisht me 19 Mars 2009 janë qe te dyja të marra duke zbatuar plotësisht dispozitat e KPPK-se, prandaj edhe janë prova te pranueshme.
28. Me tej , avokati mbrojtës kërkoi nga gjykata qe te shpalle si prova te papranueshme procesverbalet e vendit te ngjarjes te përgatitura nga policia. Mbrojta nuk ka specifikuar në mënyrë te sakte se cilët procesverbale te shpallen te papranueshme por është e dukshme se një kërkese e tillë është bere për të gjitha procesverbalet e përgatitura gjate sigurimit të provave ne vend te ngjarjes.
29. Gjykata konstaton se te gjitha provat e mbledhura nga Policia e Kosove ne vend të ngjarjes janë te pranueshme. Neni 201 i KPPK-së thotë:

### **Neni 201**

- (1) Kur eksiton dyshimi i arsyeshëm se është kryer një vepër penale qe ndiqet sipas detyrës, policia detyrohet qofte sipas detyrës zyrtarë ose me kërkesë te Prokurori Publik te ndër marr te gjitha masat e nevojshme për te përcaktuar vendodhjen e kryerësit, te ndaloj kryesin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja, te gjej dhe te ruaj gjurmët dhe privatë tjera te veprës penale, dhe sendet te cilat mund te shërbejnë si prova dhe te mbledhë te gjitha informacionet te cilat mund te përdoren ne procedure penale.*

*(2) Për te kryer detyrat nga paragrafi 1 i këtij Neni, policia ka autorizim:*

.....

*7) te konfiskoj sende te cilat duhet te merren sipas Kodit te Përkohshëm Penal ose qe mund te shërbejnë si prova ne procedure penale.*

Dispozitat e KPPK-se nuk caktojnë një obligim mbi Policinë për te lajmëruar te pandehurin apo avokatin mbrojtës te tij kur policia konfiskon sendet qe mund te shërbejnë si prova në procedurë penale. Prandaj te gjitha provat e mbledhura nga policia e Kosovës në vend ngjarje janë prova te pranueshme.

30. Edhe pse çështja e pranueshmërisë së provave, veçanërisht e përgjimit të mesazheve SMS të siguruara nga prokurori gjatë hetimit, nuk është ngritur nga mbrojtja, gjykata *ex-officio* ka vlerësuar pranueshmerinë e kësaj prove sipas Nenit 154 paragrafi (1) dhe (2) të KPPK-së. Gjykata vëren se mesazhet me SMS janë siguruar përmes një urdhri të zyrës se Prokurorisë Publike te datës 19 Shkurt 2009. Neni 258 KPK-se thotë:

***Neni 258***

- (1) *Prokurori Publik mund te jep urdhër për secilën mase te mëposhtme:*
- 1) *Fotografim te fshehte ose vëzhgim me video ne vende publike*
  - 2) *Monitorim te fshehte te bisedave ne vende publike*
  - 3) *Hetim te fshehte*
  - 4) *Regjistrim te thirrjeve telefonike*
- (2) *Gjyqtari i Procedurës Paraprake me kërkesë te Prokurori Publik mund te urdhër urdhëroj se cilën mase te mëposhtme :*
- 1) *Fotografim te fshehte ose vëzhgim me video ne vende private*
  - 2) *Monitorim te fshehte te bisedave ne vende private*
  - 3) *Kontrollim i dërgesave postare*
  - 4) ***Përgjim te telekomunikimeve***
  - 5) *Përgjim te telekomunikimeve nga rrjeti kompjuterik*
  - 6) *Dërgim te kontrolluar te dërgesave postare [theksim i shtuar]*

Dispozita e lartcekur është e qartë: Prokurori nuk ka të drejtë të autorizoj përgjimin e telekomunikimeve. Lëshimi i urdhrit për përgjim të telekomunikimeve është kompetencë ekskluzive e gjyqtarit të procedurës paraprake gjate fazës se hetimit. Dispozitat e Nenit 258 janë shkelur dhe pasojat e kësaj shkeljeje janë të përcaktuara me Nenin 264 të KPPK-së i cili thotë:

***Neni 264***

- (1) ***Provat e marra me masën e cila është nen Kapitullin <sup>1</sup> do të jenë të papranueshme,*** nëse urdhri për masën dhe implementimin është i kundërligjshëm.

Prandaj , SMS mesazhet e marra sipas urdhrit të Prokurorit të datës 19 Shkurt 2009 shpallen prova të papranueshme, kështu qeçato janë mbyllur dhe ndarë nga dosja e lëndës.

---

<sup>1</sup> Kapitulli XXIX: Masat Teknike dhe të Fshehta të Vëzhgimit dhe Hetimit të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. (2004).



31. Sidoqoftë, e vlen të përmendet se SMS mesazhet janë nxjerrë me vonë nga PTK-ja sipas urdhrorit të trupit gjykues me datën 23 Shtator 2013. Prova (CD-ja) e marrun me urdhër të gjykatës është e pranueshme.

#### V. Provat e Administruara gjate Shqyrtimit Kryesor

32. Gjate procedurës se provave gjykata administroi provat si në vijim, përveç provave të deklaruara si të papranueshme:

|    |            |   |
|----|------------|---|
| 1  | 18-Shku-09 | Flash Raport i Policisë së Kosovës  |
| 2  | 18-Shku-09 | Raporti fillestar i incidentit  |
| 3  | 18-Shku-09 | Raport i policit <b>F.A.</b> ,  |
| 4  | 18-Shku-09 | Raporti i mjekes Dr. <b>S.N.</b> ,  |
| 5  | 18-Shku-09 | Raport i hetuesit të Policisë së Kosovës <b>A.S.</b> ,                      |
| 6  | 18-Shku-09 | Deklarata e Muharrem Shillovës para policisë                                |
| 7  | 19-Shku-09 | Matjet e thirrjeve telefonike për numrin e telefonit <b>049581836</b>       |
| 8  | 19-Shku-09 | Raport i hetueses se Policisë se Kosovës <b>V.R.</b> ,                      |
| 9  | 19-Shku-09 | Flash Raport i Policisë se Kosovës  |
| 10 | 19-Shku-09 | Raport i hetuesve të Policisë se Kosovës <b>M.M.</b> , dhe <b>V.Sh.</b> ,   |
| 11 | 19-Shku-09 | Raport i hetueses se Policisë se Kosovës <b>V.R.</b> ,                      |
| 12 | 19-Shku-09 | Deklarata e <b>R.S.</b> , para policisë                                     |
| 13 | 19-Shku-09 | Deklarata e <b>V.S.</b> , para policisë                                     |
| 14 | 19-Shku-09 | Deklarata e <b>Sh.S.</b> , para policisë                                    |
| 15 | 19-Shku-09 | Deklarata e të pandehurit para policisë                                     |
| 16 | 20-Shku-09 | Fotografitë e OMPF të autopsisë nga <b>D.Sh.</b> ,                          |
| 17 | 20-Shku-09 | Raport i Ekzaminimit të veturës (24 faqe)                                   |
| 18 | 20-Shku-09 | Raport i Mjekësisë ligjore nga vendi i ngjarjes (34 faqe)                   |
| 19 | 20-Shku-09 | Raport i Autopsisë  |
| 20 | 26-Shku-09 | Raport i ekipit të Forensikës së Policisë së Kosovës të autopsisë (47 faqe) |
| 21 | 10-Mar-09  | Raport i Forensikës nga vendi i ngjarjes (9 faqe)                           |
| 22 | 17-Mar-09  | Deklarata e <b>M.Sh.</b> , para Prokurorisë                                 |
| 23 | 17-Mar-09  | Deklarata e <b>R.S.</b> , para Prokurorisë                                  |
| 24 | 17-Mar-09  | Deklarata e <b>V.S.</b> , para Prokurorisë                                  |
| 25 | 17-Mar-09  | Deklarata e <b>H.T.</b> , para policisë                                     |
| 26 | 17-Mar-09  | Deklarata e <b>Sh.S.</b> , para Prokurorisë                                 |
| 27 | 17-Mar-09  | Deklarata e të pandehurit para Prokurorisë                                  |
| 28 | 19-Mar-09  | Deklarata e <b>N.G.</b> , para policisë                                     |
| 29 | 07-Pri-09  | Deklarata e <b>N.G.</b> , para Prokurorisë                                  |
| 30 | 07-Pri-09  | Deklarata e <b>H.T.</b> , para Prokurorisë                                  |
| 31 | 22-Maj-09  | Raport nga hetuesja e Policisë së Kosovës <b>V.R.</b> ,                     |

|    |            |   |
|----|------------|---|
| 32 | 22-Maj-09  | Deklarata e <b>B.B.</b> , (aka <b>J.K.</b> )  |
| 33 | 04-Qer-09  | Raporti Psikiatrik nga Dr. <b>N.P.</b> ,  |
| 34 | 04-Qer-09  | Raporti Psikiatrik për <b>H.K.</b> ,  |
| 35 | 09-Nent-09 | Raport mbi Ekspertizën e ADN-së   |
| 36 | 16-Dhj-09  | Ekspertiza Psikiatrike  |
| 37 | 21-Sht-11  | Përgjigje nga Qendra e Ndalimit në Lipjan   |
| 38 | 21-Tet-11  | Raport i Ekspertizës Psikiatrike  |
| 39 | 24-Jan-13  | Përgjigje nga Policia e Kosovës   |
| 40 | 17-Maj-13  | Raport mbi Ekspertizën e ADN-së   |
| 41 | 23-Shta-13 | Informacion nga Gjykata Themelore e Prishtinës mbi the dhënat penale të të pandehurit |
| 42 | 23-Shta-13 | Informacion nga Gjykata Themelore e Prizrenit mbi the dhënat penale të të pandehurit  |
| 43 | 25-Sep-13  | Informacion nga Gjykata Themelore e Gjilanit mbi the dhënat penale të të pandehurit   |
| 44 | 27-Shta-13 | Raport mbi Ekspertizën e ADN-së   |
| 45 | 30-Shta-13 | Informacion nga Komuna e Prishtinës   |
| 46 | 01-Tet-13  | Informacion nga Qendra e Paraburgimit në Lipjan                                       |
| 47 | 02-Tet-13  | Informacion nga Qendra Korrektuese e Dubravës   |
| 48 | 03-Tet-13  | Informacion nga Gjykata Themelore e Gjakovës mbi the dhënat penale të të pandehurit   |
| 49 | 04-Tet-13  | Informacion nga Gjykata Themelore e Mitrovicës mbi the dhënat penale të të pandehurit |
| 50 | 04-Tet-13  | Informacion nga Gjykata Themelore e Ferizajt mbi the dhënat penale të të pandehurit   |
| 51 | 08-Tet-13  | Informacion nga Qendra e Ndalimit në Lipjan   |
| 52 | 10-Tet-13  | Informacion nga Gjykata Themelore e Pejës mbi the dhënat penale të të pandehurit      |
| 53 | 16-Tet-13  | Informacion nga PTK-ja (CD)   |

33. Për me tepër, gjykata dëgjoi dëshmitë *viva voce* të dëshmitareve si në vijim: **N.G, V.S., Sh.S, R.S., Z.G., Xh.R., B.M., B.R., D.K., I.Sh., M.R., R.H., S.V., Sh.B., E.G., Z. M-Z.**
34. Palët u pajtuan që deklaratat e mëparshme të **H.T.**, i cili punonte në Shqipëri në kohën kur shqyrtimi kryesor ishte në proces e sipër të merren si të lexuara, si dhe deklarata e Muharrem Shillovës i cili vdiq me 14 Shtator 2009. Palët, në pajtim me Nenin 368 (1)(3) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, u pajtuan që marrja e drejt-për-drejte në pyetje të dëshmitareve të lart-përmendur të cilët nuk u paraqitën në seance pasi që iu ishin dërguar thirrjet, të zëvendësohen me leximin e deklaratave të mëhershme të tyre. Kështu që, deklaratat e këtyre dy dëshmitareve ishin marrë si të lexuara si dhe janë pjesë të shkresave të lendes.

35. Dëshmitarët ekspert si në vijim ishin dëgjuar: Bashkim Mustafa, Biolog Ekspert i ADN-së, Dr. **A.G.**, patolog i cili kreu autopsinë e viktimës. Dr. **N.I-M.**, Psikiatër, **Sh.U.**, - Psikologe dhe Dr. Sh.M., Psikiatër i cili dëshmoi mbi gjendjen mentale dhe psikologjike të të pandehurit. Të tre ekspertet punuan në një ekip dhe ekspertiza u prezantua nga Dr. **N.I-M.**, dhe **Sh.U.**

## **VI. Vlerësimi i provave**

### *Deklarata e të pandehurit para policisë, Prokurorit dhe gjykatës*

36. I pandehuri u mor në pyetje nga Policia e Kosovës me 19 Shkurt 2009. Ai deklaroi si në vijim:

Më 17 Shkurt 2009 u zgjua rreth orës 9:00. Ai foli me viktimën me numrin mobil të telefonit **D** dhe u pajtuan te takohen atë ditë më vonë në Prishtinë, ne vendin ku viktima punonte si pastruese. Arsyeja e takimit ishte të bisedohet rreth një borxhi prej 2000 eurosh që viktima ia kishte të pandehurit. I pandehuri deklaroi se arriti ne Prishtine rreth orës 13:30- 14:00. Viktima dhe i pandehuri u takuan para një dyqani. Pastaj ata bashkë shkuan në një restorant në afërsi. Derisa ata ishin duke qëndruar ne restorant bisedonin rreth borxhit qe viktima ia kishte atij. Në ndërkohe viktima shkoi ne banjo dhe beri një bisedë telefonike. Viktima ia bëri atij me dije se ajo nuk do ia kthej paratë, kurse i pandehuri u mundua ta bindë atë t'i japë atij paratë. Pasi që ajo nuk donte t'i jepte paratë atij ai vendosi ta vrasë atë, kështu që ai e bindi atë qe të shkoj me të. Qëllimi i tij ishte qe ai të gjej një vend të përshtatshëm për ta vrarë atë, kështu qe ai vendosi të shkoj në fshatin **Z**. Ata arritën në **Z.**, rreth orës 16:30 po atë ditë. Kur ai arriti në fund të një rruge të pashtruar, ai ktheu makinën e tij mbrapsht dhe e voziti për rreth 100 metra dhe pastaj u ndal dhe filloi të diskutoj me viktimën për marrëdhënien e tyre. I pandehuri e kishte filluar lidhjen e tij të dashurisë me viktimën prej kohës kur ajo u fejua me djalin e vëllait të tij, d.m.th. për afërsisht qe 3 vite. I pandehuri i kishte premtuar viktimës se do ta martonte atë dhe do të blej një banese në Prishtine për të jetuar bashkë. Ata që të dy ishin dakord ne fillim porse viktima ishte me e distancuar nga i pandehuri kohëve të fundit dhe ai mendonte se ajo kishte filluar një lidhje tjetër dashurie. Derisa viktima dhe i pandehuri ishin duke diskutuar marrëdhënien e tyre ne kamionetë, i pandehuri propozoi asaj që ata ta vazhdojnë lidhjen e tyre të dashurisë, kurse viktima ishte vendosmërisht kundër. Pasi që i pandehuri e donte shume viktimën ai nuk ishte në gjendje ta shoh lidhjen e tyre duke përfunduar dhe viktima të filloi një lidhje të re me një burrë tjetër. Ai e pyeti viktimën : “ *A po vazhdojmë si më përpara apo jo* ”. Viktima iu përgjigj se gjithçka kishte marrë fund. Viktima dhe i pandehuri dolën jashtë kamionetës dhe filluan ta shtyjnë njëri tjetrin me duar. I pandehuri u mundua ta kthej viktimën brenda në kamionetë por ajo refuzoi. I pandehuri u kthye në kamionetë dhe mori një pajser prej 50 cm të gjatë dhe filloi ta qëllloi atë në kokë. Ai fillimisht e qëllloi atë në kokë, dhe pastaj në ballë. Ai ia mori asaj çantën dhe jaknën dhe e hodhi atë në pyll. I pandehuri gjithashtu tha se ai e hodhi edhe

pajserin në pyll . Pastaj e mori kamionetën dhe shkoi në shtëpi. Koha kur a kreu vrasjen ishte rreth orës 17:00 kurse në shtëpi u kthye rreth orës 20:00.

Sipas të pandehurit, ai u bë i afërt me viktimën pasi që viktima ishte fejuar me djalin e vëllait të tij. I pandehuri dhe viktima shkuan në Prishtinë të blejnë disa gjëra pasi që ajo u fejuar me **B.K.** I pandehuri i tha viktimës :” *ju jeni një vajzë shumë e bukur, ti me pëlqen*”. Viktima ju përgjigj duke thënë nëse unë të pëlqej ty atëherë te shkojmë për kafe. Ata shkuan tek një kafiteri tek rrethi përballë Hotel Baci-t në Prishtinë. Aty u puthën për herë të parë. Viktima i premtoi të pandehurit se me vonë ata do të kenë marrëdhënie seksuale. Ata e vazhduan lidhjen e tyre të dashurisë përafërsisht për tri vite.

Marrëdhëniet në mes të pandehurit dhe **V.S.**, filloi të keqësohet dy javë para vrasjes. I pandehuri mendonte se arsyeja për këtë marrëdhënie të ftohtë ishte sepse viktima kishte një lidhje tjetër dashurie. Nga pikëpamja e të pandehurit viktima nuk e kishte mbajtur premtimin e saj dhe ajo krijoi një lidhje të re. Sipas të pandehurit, ai ishte i dashuruar në **V.S.**, dhe kur ai kuptoi se viktima filloi të ishte e distancuar, ai nuk mund te pajtohej me këtë fakt dhe se e vetmja zgjedhje ishte , sipas tij, ta vriste atë. Ai nuk mund ta imagjinonte **V.S.**, duke u martuar me dikë tjetër dhe kjo ishte arsyeja pse ai vendosi ta vriste atë.

37. Më 17 Mars 2009, i pandehuri është marrë në pyetje nga ana e Prokurorit. Gjatë kësaj interviste ai ka dhënë një tregim plotësisht tjetër të ngjarjeve. I pandehuri ka thënë si në vijim:

Ai tha se ka qenë në shtëpi në fshatin **Zh.**, duke bërë disa punë shtëpie më 17 dhe 18 Shkurt 2009. Ai tha se ka pranuar dy thirrje telefonike, një nga IPKO dhe një tjetër nga VALA, por se ai nuk i ka njohur këto numra. Ai tha se nuk ka shkuar me makinën e tij gjëkund në ditën kur ka ndodhur vrasja. Ai e ka mohuar që viktima i kishte para borxh atij. Ai e ka pranuar se e ka shoqëruar **V.S.**, deri tek kursi për gjuhën që ishte përafërsisht 25 minuta larg shtëpisë së tij. Sipas tij, **V.S.**, kishte marrë 2,000 € nga vëllai i tij **B.**, nga Gjermania për koston e kursit të gjuhës, të cilat ishin marrë nga **V.S.**, në prani të **R.**, por, sipas tij, nuk qëndron fakti se ajo i kishte ndonjë para borxh atij. I pandehuri e mohon se ai kishte rënë në dashuri me viktimën. Ai më tej thotë se asnjëherë nuk ka qenë në fshatin malor të **Z.** Ai tha se nuk ka pasur ndonjë bisedë me viktimën më 17 Shkurt 2009. Numri nuk është i tij. Ai e ka mohuar që ka pasur ndonjë lidhje dashurie apo marrëdhënie seksuale me viktimën. Ai asnjëherë nuk i ka premtuar viktimës që do ta martonte atë dhe se do të divorcohej me gruan e tij. Ai e ka mohuar që ka vrarë **V.S.** Më tej ai tha se nuk është e vërtetë se dikush e kishte parë atë në dyqanin që gjendet në rrugën **I.K.**, dhe as që dikush e ka parë atë tek restoranti. Ai tha se nuk ka pasur gjak në makinën e tij dhe se nuk ka rëndësi se çfarë tregojnë analizat e ADN-së, ai nuk e ka vrarë viktimën. Ai tha se djemtë e xhajës së tij **Sh.K.**, dhe **E.K.**, e kanë parë atë në mëngjesin e datës 17 Shkurt 2009 duke punuar me lopatë në kopshtin e tij. I pandehuri tha se deklaratën e tij në polici e kishte dhënë nën presion. Ai më tej tha se avokati i tij kishte ardhur me vonesë gjatë

marrjes në pyetje. I pandehuri tha se ai ishte rrahur nga Policia dhe se nuk e dinte nëse lëndimet trupore të tija ishin fotografuar pasi që ai ishte rrahur nga Policia. Atij gjithashtu nuk i kujtohet se kur është fotografuar nga policia duke mbajtur një letër përpara tij.

38. Më 18 Tetor 2013, i pandehuri ka dhënë dëshmi para trupit gjykues. I pandehuri ka dëshmuar si në vijim:

I pandehuri ka dëshmuar para gjykatës duke thënë se deklarata e dhënë në polici ishte dhënë për shkak të rrahjeve të bëra nga policia. Ai tha se ia kishin futur kokën në një kovë me ujë dhe se gati po vdiste, ku si rezultat i kësaj, ai kishte dhënë këtë deklaratë në presion dhe ka inkriminuar veten e tij. I pandehuri tha se Avokatja e tij Mbrojtëse kishte ardhur pasi që policia i kishte mbaruar procedurat. Sipas tij, policia nuk i kishte shtruar ndonjë pyetje kur avokatja e tij mbrojtëse ishte e pranishëm. I pandehuri e mohoi që ai kishte nënshkruar deklaratën e dhënë në polici. I pandehuri tha para gjykatës se në ditën kritike ai ka qëndruar në shtëpi dhe ka punuar tokën e kopshtit. Përveç kësaj, ai tha se nuk ka dhënë ndonjë deklaratë para prokurorit, dhe se procesverbali i intervistës para prokurorit nuk ishte nënshkruar nga ai. Ai tha se ka qëndruar në heshtje para prokurorit. Ai e ka mohuar se tekst-mesazhet SMS janë dërguar nga numri i tij telefonik. Më tej, ai tha se nuk kishte komunikuar përmes telefonit me viktimën në ditën e vrasjes.

39. Gjykata konstaton se deklarata e të pandehurit e dhënë para Policisë së Kosovës më 19 Shkurt 2009, në përgjithësi është e besueshme. Në këtë deklaratë, i pandehuri tha se në mëngjesin e datës 17 Shkurt 2009, ai kishte pasur një bisedë telefonike me viktimën dhe se ishte pajtuar që të takoheshin me viktimën më vonë në Prishtinë. Kjo deklaratë mbështetet me faktin se regjistrimi i numrit **G**, i cili ishte në posedim të të pandehurit, tregon se ka ndodhur një bisedë ndërmjet këtij numri dhe numrit **A**, numër i cili ishte në posedim dhe pronësi të **V.S**. Kjo bisedë ka filluar në orën 07:53 dhe ka mbaruar në orën 08:10. I pandehuri tha se ka pranuar një thirrje telefonike në numrin **D**, por se kjo mund të ketë qenë ndonjë gabim nga ana e të pandehurit, apo mund të ketë ndodhur ndonjë bisedë shtesë në këtë numër. Megjithatë, PTK nuk ka paraqitur ndonjë informacion për këtë numër për vitin 2009. Sipas informacioneve të siguruara nga PTK-ja, ky numër ishte shitur në vitin 2009. Duke menduar që kur numrat nuk janë aktiv për një periudhë kohore të gjatë, ato zakonisht ri-shiten tek palët e treta, pastaj ka shumë mundësi që ky numër mund të jetë shitur tek një palë e tretë për shkak të mos-përdorimit për kohë të gjatë, meqenëse i pandehuri ka qenë në paraburgim që prej datës 19 Shkurt 2009.

40. Më tej, i pandehuri tha se e ka takuar viktimën në Prishtinë afër shtëpisë ku ajo po punonte si pastruese, dhe se së bashku ka shkuar për të pirë nga një kafe në restorantin "**R.**", i cili është afër shtëpisë ku viktima po punonte si pastruese. Kjo deklaratë vërtetohet nga deklaratat e dëshmitarëve **H.T.**, dhe **N.G. H.T.**, tha para policisë dhe prokurorit se ai e kishte parë viktimën dhe një burrë mashkull rreth moshës 38-40 vjet, me çehre të errët (*zeshkan*), me gjatësi prej 180 centimetrave, duke biseduar afër shtëpisë ku

viktima po punonte më 17 Shkurt 2009. Person i gjinisë mashkullore po fliste me zë të lartë kundrejt viktimës. Dëshmitari e identifikoi personin mashkull si personi në fotografinë me nr. 5 të rreshtit fotografik i përgatitur nga Policia e Kosovës. Gjykata nënvizon se personi në fotografinë me nr. 5 është i pandehuri. **H.T.**, më tej tha se pak minuta më vonë, ai kishte parë viktimën dhe të pandehurin duke pirë kafe në restorantin “**R.**”, dhe pastaj duke u larguar nga aty së bashku në drejtim të afërsisë së varrezave. Në shtesë të kësaj, dëshmitari **N.G.**, i cili po punonte si banakier dhe kamarier në restorantin “**R.**”, tha para prokurorit dhe gjithashtu para policisë dhe gjykatës, se ai kishte parë një person mashkull dhe femër duke pirë kafe në restorantin e tij. Ai potencoi para policisë se personi në fotografinë me numër 5 në rreshtin fotografik i ngjanë personit që ka qenë duke pirë kafe rreth orës 15:00 më 17 Shkurt 2009. Kështu që, deklarata e të pandehurit, deklarata e **H.T.**, dhe deklarata e **N.G.**, e vërtetojnë njëra tjetrën në mënyrë të përsosur në lidhje me këtë pikë.

41. Për më tepër, i pandehuri ka thënë në polici se pas që ndodhi vrasja, ai i ka hequr xhakëtën dhe portofolin nga viktima dhe i ka hedhur ato pak metra më larg nga kufoma. Xhaketa e viktimës është gjetur nga Policia e Kosovës në vend-ngjarje pasi që janë informuar nga ana e të pandehurit. Xhaketa është shënuar me provën nr. VN#8 dhe është gjetur 9.3 metra larg nga vendi ku është gjetur viktima. Deklarata e të pandehurit mbështet konstatimet e Policisë së Kosovës në vend-ngjarje.
42. Deklarata e të pandehurit që ai kishte lidhje dashurie me viktimën mbështetet nga tekst mesazhet SMS të pranuar nga PTK-ja më 16 Tetor 2013. Nga përmbajtja e tekst mesazheve SMS, del qartë që i pandehuri kishte një lidhje dashurie me viktimën. I pandehuri e ka pranuar në deklaratën e tij të dhënë para Policisë së Kosovës se ai po përdorte numrin telefonik **E**, ndërsa anëtarët familjar të viktimës kanë dëshmuar që viktima po përdorte numrin telefonik **F**.
43. Kështu që, gjykata konstaton se deklarata e të pandehurit e dhënë para policisë është në përgjithësi e besueshme. Kjo provë vërtetohet me prova të tjera të siguruara gjatë fazës së hetimit dhe gjatë fazës së gjykimit.
44. Deklarata e të pandehurit e dhënë para Prokurorit më 27 Prill 2009 paraqet një tregim tjetër të ngjarjeve që ndodhën gjatë datës 17 Shkurt 2009. I pandehuri e mohon që ai ka kryer vrasjen. Ai e mohon që ka takuar viktimën në ditën kritike. Ai e ka mohuar që ka pasur një bisedë telefonike me viktimën. Ai e ka mohuar që kishte një lidhje dashurie me viktimën. Ai tha se ishte rrahur nga policia dhe se kjo ishte arsyeja se pse ai ka pranuar se e kishte kryer vrasjen. Për herë të parë ai paraqiti një alibi duke potencuar se ai kishte qëndruar në shtëpi gjatë gjithë ditës së datës 17 Shkurt 2009.
45. Kjo deklaratë bie poshtë nga provat e tjera të administruar gjatë gjykimit: deklarata e mëparshme e dhënë në Policinë e Kosovës, deklarata e **H.T.**, dhe deklarata e **N.G.** Prandaj, gjykata konstaton se deklarata e të pandehurit e dhënë para Prokurorit nuk është e besueshme.

46. I pandehuri e mohon kryerjen e veprës penale gjatë gjykimit. Ai tha se nuk e kishte nënshkruar deklaratën e dhënë para Policisë së Kosovës dhe gjithashtu ai pretendon se nuk e ka nënshkruar deklaratën e dhënë para prokurorit.
47. Kjo deklaratë bie poshtë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga provat e dhëna nga dëshmitarja **Z.M-Z.**, e cila ka vepruar si avokatja e tij mbrojtëse më 19 Shkurt 2009. Dëshmitarja pohon se nuk është ushtruar ndonjë dhunë kundër të pandehurit dhe se ai e kishte nënshkruar deklaratën e dhënë para policisë. Prandaj, deklarata e dhënë para trupit gjykues nuk është e besueshme dhe e qëndrueshme. Për më tepër, i pandehuri ka mohuar që të ketë nënshkruar deklaratën e dhënë para prokurorit gjithashtu. Gjykata konstaton se kjo është veçse një përpjekje e pasuksesshme e të pandehurit me qëllim që të shmang përgjegjësinë penale. Me fjalë të tjera, kjo është si një strehë për një të dëshpëruar.

#### *Deklarata e dëshmitarit H.T., e dhënë para policisë dhe prokurorisë*

48. **H.T.**, është marrë në pyetje nga Policia e Kosovës më 17 Mars 2009. Ai tha se ka punuar për tre vjet si menaxher për kompaninë "**A.T.**". Dëshmitari tha se më 17 Shkurt 2009 (Dita e Pavarësisë), kishte filluar punën në orën 07:30 dhe e kishte përfunduar në orën 14:00. Rreth orës 15:30, ai kishte shkuar që të kontrollonte derën e prapme të marketit, që gjendet pas ndërtesës dhe ku është dera hyrëse e shtëpisë së **S. H.** Ai e ka parë **V.S.**, duke bërë një bisedë të nxehtë me një burrë. Dëshmitari e përshkruan këtë personin mashkull të ketë qenë rreth 180 cm i gjatë, me moshë prej 38-40 vjeç. Më tej, dëshmitari e ka identifikuar personin që ishte duke biseduar me **V.S.**, burri që ishte në fotografinë me nr. 5 të rreshtit fotografik<sup>2</sup> të përbërë nga pesë fotografi të personave të ndryshëm. Dëshmitari e njihte **V.S.**, edhe më përpara pasi që të dy po punonin për të njëjtën familje. Sipas dëshmitarit, viktimja dhe i pandehuri kanë biseduar përafërsisht 5 minuta dhe pastaj janë larguar. Pak minuta më vonë, dëshmitari ka shkuar në restorantin "**R.**", për të pirë një çajë meqenëse ishte ftohtë përjashta. Ai ka parë të pandehurin dhe viktimën së bashku duke pirë kafe. Dëshmitari ka qëndruar rreth 10 deri 15 minuta në restorant dhe pastaj është larguar që të shkonte në pjesën e përparme të marketit ku ai punonte. Rreth 15 minuta pasi që ai u largua nga restoranti "**R.**", viktimja së bashku me të pandehurin kanë dalë jashtë dhe kanë ecur në drejtim të monumentit (varrezave të dëshmorëve).
49. Dëshmitari është intervistuar nga prokurori më 7 Prill 2009. Deklarata e tij e dhënë para policisë përputhet me deklaratën e dhënë para prokurorit. Gjykata nuk ka vërejtur ndonjë mos-përputhje ndërmjet këtyre dy deklaratave.
50. Dëshmitari nuk ka dëshmuar para gjykatës meqenëse palët pranuan që deklaratat e tij të dhëna para policisë dhe prokurorisë të konsiderohen si të lexuara. Gjykata u përpoq që të

---

<sup>2</sup> I pandehuri **H.K.**, është paraqitur në fotografinë me numër 5.

thërras dëshmitarin por fleta e dorëzimit-pranimi është kthyer prapa që tregonte se i pandehuri nuk jetonte në adresën që ai i kishte dhënë Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë. Gjykata e telefoni dëshmitarin dhe e lajmëroi atë që të vinte për të dëshmuar në gjykatë por ky i fundit ishte përgjigjur duke thënë se punonte në Shqipëri, dhe se nuk ishte e mundur për të që të vinte në gjykatë, për shkak se në rast të kundërt mund të humbte punën. Duke marrë parasysh që palët u pajtuan që deklaratat e tyre të merren si të lexuara, gjykata nuk bëri përpjekje të mëtejshme për të detyruar këtë dëshmitar që të vinte për të dëshmuar në gjykatë.

51. Për sa i përket besueshmërisë së kësaj deklaratë, gjykata konstaton se dëshmia e dëshmitarit vërtetohet plotësisht nga deklaratat e dëshmitarit **N.G.** Në shtesë, deklarata e tij e parë është në përputhshmëri me deklaratën e dhënë para prokurorit. Dëshmitari nuk ka pasur ndonjë motiv apo arsye për të gënjyer Prokurorinë apo Policinë. Prandaj, gjykata konstaton se deklaratat e **H.T.**, janë të besueshme dhe të qëndrueshme.

#### *Deklarata e dëshmitarit N.G., e dhënë para policisë, prokurorisë dhe gjykatës*

52. **N.G.**, ka dhënë deklaratën e tij para Policisë së Kosovës më 19 Mars 2009. Ai u ka treguar policisë se punonte si kamarier në restorantin "**R.**". Më 17 Shkurt 2009, ai e kishte filluar punën në restorant në orën 08:00. Rreth orës 15:00 një person i gjinisë femërore, e moshës 25 vjeçare, jo dhe aq e gjatë, me peshë normale, flokë të zeza, me pantallona të zeza, së bashku me një burrë, të dobët, me flokë me ngjyrë kafe, rreth 175-180 cm i gjatë, i moshës rreth 35-40 vjeç, kanë pirë nga një kafe në restorantin që ai punonte. Dëshmitari e ka identifikuar këtë burrin që i ngjante personit në fotografi me numrin 5 të rreshtimit fotografik. Sipas dëshmitarit, çifti ka qëndruar atje për rreth një orë dhe pastaj janë larguar në një drejtim të paditur për të.
53. I njëjti dëshmitar ka dhënë një deklaratë para prokurorit më 7 Prill 2009. Deklarata e dhënë para prokurorit është në përputhje me deklaratën e tij të dhënë para policisë.
54. Më 20 Shtator 2013, dëshmitari **N.G.**, ka dëshmuar para gjykatës. Ai ka dëshmuar që më 17 Shkurt 2009, ai ka qenë duke punuar si kamarier/banakier në restorantin "**R.**". Dëshmitari është hutuar para gjykatës dhe se nuk i kujtoheshin ngjarjet në mënyrën e duhur. Eventualisht, kur ai u ballafaqua me deklaratat e tij të mëparshme të dhëna para policisë dhe para prokurorit, dëshmitari i qëndroi në tërësi asaj që ai kishte thënë përpara në fazën hetimore.
55. Gjykata konstaton se deklaratat e dëshmitarit të dhëna para policisë dhe prokurorisë janë më shumë të besueshme. Ai i ka dhënë këto deklarata pas një periudhe të shkurtër kohore kur ndodhi ngjarja, ndërsa dëshmia e dëshmitarit të dhënë para gjykatës është pothuajse 5 vjet më vonë se sa kur ka ndodhur ngjarja. Me tej, deklaratat e dëshmitarit të dhëna para policisë dhe prokurorisë vërtetohen me provat e tjera që janë në shkresat e lëndës, në veçanti deklarata e **H.T.**



***Deklarata e dëshmitares Z.M-Z., e dhënë para gjykatës***

56. Dëshmitarja ka shërbyer si avokate e të pandehurit kur ai është marrë në pyetje nga policia më 19 Shkurt 2009. Ajo tha se i pandehuri ishte marrë në pyetje në pajtim me dispozitat procedurale dhe se nuk ishte ushtruar asnjë lloj dhune kundër tij në prezencën e saj. Ajo me tej, dëshmoi se ka qenë i pandehuri ai që ka nënshkruar deklaratën e tij në çdo faqe. Ajo gjithashtu potencoi se edhe ajo e kishte nënshkruar të njëjtën deklaratë. Gjithashtu, ajo tha se deklaratat në mënyrë të saktë reflekton atë që i pandehuri kishte thënë gjatë intervistës së tij.
57. Kjo deklaratë në mënyre direkte i hedh poshtë pretendimet e të pandehurit se ai ishte rrahur gjatë intervistës. Më tej, i pandehuri e mohon që të ketë nënshkruar deklaratën, gjë që mohohet nga dëshmia e avokates.
58. Prandaj, gjykata konstaton që dëshmia e kësaj dëshmitare është e besueshme dhe e qëndrueshme, sepse ajo vërtetohet edhe me prova të tjera të lëndës, pra, me deklaratën e Hetuesit **Z.G.**, dhe procesverbalet e deklaratës së të pandehurit të dhënë para policisë.

***Deklaratat e dëshmitarit R.S., para policisë, prokurorit dhe gjykatës***

59. **R.S.**, është babai i viktimës. Deklaratat e këtij dëshmitari përputhen me njëra tjetrën. Gjykata gjen këtë dëshmitar të besueshëm. Gjykata vëren se dëshmia e tij në përgjithësi ka lidhje me faktet të cilat nuk kontestohen nga palët në këtë lëndë.

***Deklaratat e dëshmitarit Sh.S., para policisë, prokurorisë dhe gjykatës***

60. **Sh.S.**, është xhaxhai i viktimës. Deklaratat e këtij dëshmitari përputhen me njëra tjetrën. Gjykata gjen këtë dëshmitar të besueshëm. Gjykata vëren se dëshmia e tij në përgjithësi ka lidhje me faktet të cilat nuk kontestohen nga palët në këtë lëndë.

*Deklaratat e dëshmitarit V.S., para policisë, prokurorisë dhe gjykatës*

61. **V.S.**, është motra e viktimës. Deklaratat e kësaj dëshmitareje përputhen me njëra tjetrën. Gjykata gjen këtë dëshmitare të besueshme. Gjykata vëren se dëshmia e tij në përgjithësi ka lidhje me faktet të cilat nuk kontestohen nga palët në këtë lëndë.

*Deklaratat e oficerëve të policisë dhe zyrtarëve të tjerë*

62. Oficerët e listuar më poshtë u ftuan zyrtarisht dhe dëshmuan para gjykatës: **Z.G., Xh.R., B.M., B.R., D.K., I.Sh., M.R., R.H., S.V., Sh.B.**, dhe **E.G.**. Secili prej tyre spjegoi përfshirjen e tij në këtë lëndë. Deklaratat e tyre janë të besueshme dhe shpjegojnë vetëm raportet me shkrim në dosjen e lëndës.

*Deklarata e dëshmitarit U.K., e dhënë para gjykatës*

63. **U.K.**, është babai 78 vjeçar i të pandehurit. Ai është propozuar që të dëgjohet si dëshmitar nga ana e mbrojtjes në mënyrë që të paraqes alibinë për të pandehurin. Ai ka dëshmuar para gjykatës me datën 19 Shtator 2013. Dëshmia e tij është si në vijim:
64. Në ditën kur viktima është vrarë i pandehuri ka qenë duke punuar në kopsht me një lopatë. Në ditën kritike i pandehuri është zgjuar nga gjumi, i pari nga të gjithë, diku rreth orës 8:00, kishte ngrënë mëngjes (supë dhe lëngë) së bashku me familjen, kishte pirë çaj dhe pastaj kishte filluar punën në kopsht. I pandehuri kishte punuar aty tërë ditën. Dëshmitari i kujtohej se i pandehuri ishte zgjuar i pari atë ditë. Anëtarët e familjes kishin ngrënë supë dhe long për mëngjes. Dëshmitari dhe i pandehuri, së bashku me anëtarët e tjerë të familjes kishin ngrënë drekë së bashku. Koha atë ditë ishte e mirë dhe nuk ishte duke rënë borë e poashtu edhe toka nuk ishte e ngrirë.
65. Gjykata gjen se kësaj dëshmie i mungon besueshmëria. Gjykata merr parasysh se edhe përkundër faktit se dëshmitari ishte në gjendje të mbaj në mend disa detaje interesante lidhur me datën 17 Shkurt 2009, ai megjithatë nuk mund të mbante mend se cili ishte viti në kohën kur po jepte dëshminë e tij para trupit gjykues. Më tej, gjykata e merr parasysh faktin se dëshmitari është babai i të pandehurit dhe ka motiv të fortë për të dëshmuar në këtë mënyrë dhe krejt kjo për ta mbrojtur djalin e tij. Pastaj, dëshmia e tij nuk përputhet me provat e tjera në këtë rast, përveç me dëshmitë e familjarëve të të pandehurit (nënës dhe gruas), dhe është në kontradiktë me provat e tjera të rastit: p.sh., Deklarata e **H.T.**, dhe **N.G.**, si dhe deklarata e vet të të pandehurit e dhënë në Policinë e Kosovës me datën 19 Shkurt 2009.

***Deklarata e dëshmitares F.K., e dhënë para gjykatës***

66. **F.K.**, është nëna 82 vjeçare e të pandehurit. Ajo është propozuar që të dëgjohet si dëshmitare nga ana e mbrojtjes në mënyrë që të prezantojnë alibinë e të pandehurit. Ajo ka dëshmuar para gjykatës me datën 19 Shtator 2012 dhe ka deklaruar si në vijim:
67. Ajo nuk e dinte se kur është vrarë viktimja, por e dinte se i pandehuri ishte në shtëpi gjithë ditën. Ajo e kujtonte se ishte ditë e Enjte. Ajo nuk e dinte datën, muajin apo vitin në kohën kur e jepte dëshminë e saj.
68. Gjykata gjen se kësaj dëshmie i mungon besueshmëria. Gjykata konsideron se aftësia e kësaj dëshmitare për të kujtuar ngjarjet që kanë ndodhur pesë vite më herët është e diskutueshme. Më tej gjykata merr parasysh se dëshmitarja është nëna e të pandehurit dhe ka motiv të fortë për të dëshmuar në këtë mënyrë për ta mbrojtur djalin e saj. Pastaj, deklarata e saj e dhënë para trupit gjykues nuk përputhet me provat e tjera, përveç dëshmimeve të familjarë të ngushtë të të pandehurit (babait dhe gruas) dhe mbetet në kontradiktë me provat e tjera bindëse të këtij rasti si deklarata e **H.T.**, dhe ajo e **N.G.**, e poashtu edhe deklarata e të pandehurit e dhënë në Policinë e Kosovës me datën 19 Shkurt 2009.

***Deklarata e dëshmitares B.K., e dhënë para gjykatës***

69. **B.K.**, është gruaja e të pandehurit. Ajo është propozuar që të dëgjohet si dëshmitare nga ana e mbrojtjes në mënyrë që të paraqitet alibia për të pandehurin. Ajo ka dhënë dëshminë e saj me datën 19 Shtator 2012 dhe ka deklaruar si në vijim:
70. Dëshmitarja mban mend se i pandehuri ka qenë në shtëpi në ditën kur viktimja është vrarë. Ajo ka deklaruar se viktimja ka jetuar në shtëpinë e tyre për përafërsisht dy muaj. Viktimja gjatë kësaj kohe shkonte në kurs të gjuhës së bashku me të pandehurin tri herë në javë. Ajo e mbante mend se në ditën kur ishte vrarë **V.S.**, koha ishte me diell.
71. Gjykata gjen se kësaj dëshmie i mungon besueshmëria. Gjykata merr parasysh se dëshmitarja duke qenë gruaja e të pandehurit dhe duke qenë nënë e fëmijëve të tij, ka motive të forta që të jap dëshminë ashtu siç e ka dhënë në mënyrë që të mbrojë bashkëshortin e saj. Pastaj, deklarata e dhënë para trupit gjykues nuk gjen mbështetje në provat e tjera përveç deklaratave të familjarëve të ngushtë të të pandehurit (babait dhe nënës), dhe është në kontradiktë me dëshmitë tjera bindëse në këtë rasti si deklarata e **H.T.**, dhe ajo e **N.G.**, e poashtu edhe deklarata e vet të të pandehurit e dhënë në Policinë e Kosovës me datën 19 Shkurt 2009.

### **Mesazhet telefonike SMS**

72. Shkëmbimet e mesazheve SMS mes numrit të telefonit **E**, në posedim të **H.K.**, dhe numrit të telefonit **F** përdorur nga viktimja tregojnë qartë se mes të pandehurit dhe viktimës kishte një lidhje dashurie.
73. Më tej, përmbajtja e mesazheve telefonike SMS zbulon se gjatë muajit shkurt 2009 viktimja ka marrë disa mesazhe telefonike SMS me përmbajtje kërcënuese. Më datë 12 shkurt 2009 i pandehuri i shkroi viktimës si në vijim ‘ *ti ke harruar të gjitha gjërat e mia që të kam bërë, s’ka problem. Ti harron personin që të ka dashur të me gjithë zemër, por do të shohësh së çfarë do të ndodhë pa mua. Duhet të dish se mund të t’a kthej këtë ty kurdo që dua*’. Gjithashtu më datë 13 shkurt 2009, në orën 10:43 i pandehuri i shkruan viktimës ‘ *duhet të dish se këtë po ia bën vetes, do të shohësh më vonë se kush jam*’.
74. Kjo provë ndihmoi gjykatën për të zbuluar motivin e të pandehurit për të vrarë viktimën. Kjo e fundit me sa duket donte t’i japë fund lidhjes, ndërkohë që i pandehuri nuk mund të imagjinonte që viktimja të martohej me dikë tjetër.
75. Për më tepër, kjo provë tregon se më datë 14 shkurt 2009 i pandehuri shkroi:

*“Zemra po më vdes dhe shpirti po më digjet. Kurrkush nuk kujdeset për mu përveç tërnakopit. Pranvera do të vijë, lulet do të çelin dhe qyqja do të vajtojë në varrin e H.”*

Ky tekst tregon sa i dëshpëruar ishte i pandehuri për faktin se viktimja kishte në plan që t’a linte. Për më tepër kjo hedh poshtë në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimin e të pandehurit se ai kishte humbur telefonin mobil shumë më herët dhe se nuk ishte përpjekur asnjëherë të riaktivizonte numrin nga kompania e shërbimit telefonik.

### **Regjistrimi i thirrjeve telefonike**

76. Kjo dëshmi tregon se më datë 19 shkurt 2009 numri i telefonit **A** ka komunikuar me numrin e telefonit **G**. Numri i parë ishte në posedimin e viktimës ndërkohë që numri i dytë ishte në posedim të të pandehurit. Kjo dëshmi mbështet deklaratën e dhënë nga i pandehuri i cili ka dëshmuar se në mëngjesin e datës 17 shkurt 2009 ai kishte komunikuar me viktimën dhe kishin rënë dakord të takoheshin më vonë në Prishtinë.

### **Raportet e ekspertizës ADN**

77. Në këtë lëndë janë kryer tre ekspertiza të ADN-së: e para më datë 9 nëntor 2009, e dyta më datë 17 maj 2013 dhe e treta më datë 27 shtator 2013.
78. Ekspertiza e parë është kryer për tre njolla gjaku E#9.1, E#9.2, dhe E #9.3 të cilat u gjetën brenda në makinë e cila është pronë e të pandehurit. Përfundimet e ekspertizës

ishin se njollat e gjakut 9.1 dhe 9.2 ishin të viktimës, ndërsa njolla e gjakut 9.3 ishte një përzierje e ADN-së së viktimës dhe një mashkull anonim.

79. Ekspertiza e dytë e ADN-së arriti përfundimin se kontribuuesi anonim e ADN-së nuk ishte i pandehuri. Është e rëndësishme të përmendet se njolla e gjakut 9.3 ishte marrë nga dyshemeja e makinës. Duke pasur parasysh se kjo njollë gjaku është marrë nga dyshemeja e makinës është e mundur që gjaku është mpiksuar në dysheme, dyshemeje ka qenë tashmë e kontaminuar me pështymë, gjak dhe lëngje të tjera të trupit që ishin në makinë. Pështyma, gjaku apo lëngje të tjera trupore në dysheme mund të jenë të ndonjë individi tjetër mashkull. Duhet të theksohet se i pandehuri ka përdorur kamionin e tij për të transportuar qymyr dhe ka mundësi që ai të ketë transportuar shumë klientë. Prandaj, ekspertiza ADN-së që tregon se njolla e gjakut përbëhet nga dy profile ADN-je nuk përjashton përgjegjësinë penale të të pandehurit. Kjo provë nuk është në mospërputhje me provat e tjera në dosjen e lëndës. Për më tepër, kjo tregon vetëm se gjaku i viktimës është shfaqur në kamionin e të pandehurit. Është shumë e mundur që ky gjak i viktimës është shfaqur gjatë kohës kur ka ndodhur krimi. Si rrjedhojë e dëshmisë të të pandehurit është e qartë se makina ishte parkuar afër vendit ku më vonë u gjet trupi; i pandehuri është përpjekur të tërheq viktimën në makinë dhe ka mposhtur rezistimin e saj. Vetëm pastaj ai ka marrë levën nga makina dhe ka filuar të godasë viktimën në kokë.
80. Analiza e tretë e ADN-së është bërë në bazë të kërkesës së këtij trupi gjykues. Gjykata urdhëroi marrjen e profileve të ADN-së, nëse ka pasur, nga dëshmitë VN#3, VN#4, VN#5 dhe VN#9. Megjithatë eksperti nuk ka qenë në gjendje të marrë ndonjë profil të ADN-së nga dëshmitë e përmendura.

### ***Raporti mbi ekspertizën e autopsisë***

81. Raporti i autopsisë vërteton se viktima është vrarë në mënyrë brutale dhe të dhunshme. Kryerësi ka vepruar në mënyrë të pamëshirshme dhe të dhunshme sepse viktima është goditur disa herë në kokë duke i shkaktuar viktimës lëndime të rënda trupore të cilat kanë shkaktuar vdekjen e saj. Trupi i viktimës ishte deformuar aq shumë sa edhe anëtarët e familjes e patën të vështirë ta identifikonin.
82. Opinioni i ekspertit të mjekësisë ligjore është konsideruar si shumë profesional, i hollësishëm dhe bindës. Eksperti shpjegoi mekanizmin si janë shkaktuar lëndimet dhe mjetin e vrasjes, duke përjashtuar në mënyrë të vendosur shifrën metalike e cila është gjetur afër dhe duke treguar *inter alia* gurin dhe nuk përjashtoi levën e metalit si armën që ka shkaktuar lëndimet.

### ***Raporti i ekspertizës lidhur me gjendjen mendore të të pandehurit***

83. Lidhur me gjendjen mendore të të pandehurit janë bërë dy raporte ekspertize. I pari është bërë më datë 16 dhjetor 2009 dhe i dyti më datë 21 tetor 2011.

84. Përfundimet e raportit të ekspertizës së datës 16 dhjetor 2009 janë si më poshtë:

1. Në bazë të shënimeve në dispozicion, mund të arrijmë në përfundimin se pacienti tregon shenja psikopatike të personalitetit të cilat nuk pajtohen me kriteret e diagnozës për një nënloj të veçantë të një çrregullimi personaliteti si kategori specifike. Më tej, nga shënimet e tij mjekësore nuk ka prova se ai ka vuajtur nga ndonjë sëmundje apo çrregullim mendor të llojit psikotik dhe se nuk ka pasur zhvillim të vonë mendor apo shënime të ndonjë lloji psikotik se ka qenë në vartësi të substancave psikoaktive respektivisht alkoolit.
2. Duke marrë në konsideratë vlerësimin e diagnozës dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale konsiderojmë se pacienti nuk ka pasur aftësi të zvogëluar mendore për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e tij.
3. Shpalosja psikotike manifestuar nga pacienti gjatë vëzhgimit aktual është reagim në rrethana kriminale në drejtim të situatës me të cilën ai është përballur dhe sipas vlerësimit tonë përcaktohet kryesisht nga tendenca të vetëdijshme dhe nuk ka psikozë reale.
4. Prandaj gjendja mendore ka qenë e njëjtë.

85. Përfundimet e raportit të ekspertizës së datës 21 tetor 2011:

- a. Mendojmë se **H.K.**, do të jetë në gjendje të ndjekë procesin gjyqësor, ai do të ketë shumë probleme, ankesa somatoforme si psh: dhimbje të trupit, ankesa si rezultat i tensioneve nervore dhe traumave, ankesa për shkak të "humbjes së vetëdijes".
- b. Ankesat e përmendura janë të pranishme gjatë gjithë kohës në deklaratat e tij dhe kjo nuk do të pamundësojë atë që të marrë pjesë në procesin gjyqësor.

86. Të dy raportet e ekspertizës kanë arritur në të njëjtin përfundim, se: i pandehuri është në gjendje marrë pjesë në gjykim dhe se i pandehuri ishte mendërisht i aftë dhe se nuk ka aftësi të zvogëluar mendore.

87. Në raportin e parë të ekspertizës është arritur në përfundimin se i pandehuri kishte disa elementë të psikopatisë por se nuk bie plotësisht në kategorinë e psikopatit. Megjithatë është e rëndësishme të përmendet se psikopatia nuk është çrregullim mendor por çrregullim personaliteti.

### ***Dokumentacioni mjekësor përgatitur në Qendrën Korrektuese në Dubravë në kohën kur i pandehuri ishte në paraburgim***

88. Mbrojtja pretendon se i akuzuari është rrahur rëndë nga policia dhe kështu që ai pranon veprën penale se kishte shumë hematoma në pjesë të ndryshme të trupit. Ky pretendim është hedhur poshtë nga prova e siguruar nga Qendra Korrektuese në Dubravë. Një doktor bëri një kontroll të përgjithshëm të të pandehurit më datë 21 shkurt 2009. Sipas

këtij dokumentacioni mjekësor i pandehuri ishte në gjendje të mirë shëndetësore. Doktorit që bëri kontrollin mjekësor nuk vuri re asnjë shenjë dhune.

### ***Përgjigje nga Policia e Kosovës më datë 24 janar 2013***

89. Gjykata përmes kryetarit të mëparshëm gjykues i dërgoi një letër stacionit të policisë së Kosovës, për të kërkuar informata nëse **H.K.**, ka raportuar një telefon si të humbur. Policia u përgjigj se në policinë e Kosovës nuk ka shënime të cilat tregojnë se i pandehuri ka raportuar ndonjë telefon si të humbur.
90. Kjo provë hedh poshtë pretendimet e të pandehurit se telefoni nuk ishte në përdorim nga ai.

### **VII. Gjendja faktike e vërtetuar**

91. Sipas provave të administruara gjatë fazës së shqyrtimit kryesor gjykata pas vlerësimit të kujdesshëm të provave të pranueshme, ka vërtetuar faktet ne vijim:
92. **V.S.**, një vajzë e re nga fshati Sllovi, komuna e Lipjanit, është njoftuar me **B.K.**, nga fshati **Zh.**, Komuna e Vushtrisë, me banim në Gjermani nëpërmjet ndërmjetësimit të xhaxhait të saj **Sh.S.**, dhe nga njëri prej anëtarëve të familjes së **B.K.** Fillimisht, **V.S.**, dhe **B.K.**, u fejuan në 2007 dhe më pas ata u martuan në vitin 2008. **V.S.**, dhe **B.K.**, kanë planifikuar të jetojnë së bashku në Gjermani, kështu që **B.K.**, ka filluar përgatitjet për të rregulluar dokumentacionin në mënyrë që **V.S.**, të mund të jetojë së bashku me të. **V.S.**, ka filluar të ndjekë një kurs të gjuhës gjermane në mënyrë që të përmbushë kërkesat për vizë. **B.K.**, kërkoi nga xhaxhai i tij **H.K.**, që ai të shoqëronte **V.S.**, në kursin e gjuhës. **B.K.**, ka paguar për shpenzimet e transportit të të pandehurit, ndërsa ai ofronte transportin për **V.S.** I pandehuri gjithashtu shoqëronte **V.S.**, në ambasadën gjermane dhe në vende tjera kurdo që ajo kishte nevojë për të shkuar atje. Gjatë kësaj kohe **H.K.**, dhe **V.S.**, filluan një aferë dashurie. **H.K.**, i ka premtuar **V.S.**, se do të shkurorëzonte gruan e tij dhe do të martohet me të, se do të blejë një apartament në Prishtinë dhe pastaj të jetonin së bashku. Kjo aferë dashurie zgjati për disa vite.
93. Pas martesës së **B.K.**, dhe **V.S.**, kjo e fundit u zhvendos për të jetuar në shtëpinë e familjes **K.**, në fshatin **Zh.**, në Vushtrri. **V.S.**, jetonte me gjyshërit e **B.K.**, me **H.K.**, si dhe me gruan dhe fëmijët e **H.K.** Ajo kaloi disa muaj duke jetuar në këtë shtëpi, pa burrin e saj.
94. **R.S.**, babai i **V.S.**, ka kërkuar nga **B.K.**, dhe familja e tij që ai ta marrë **V.S.**, në Gjermani për të jetuar së bashku sa më shpejt të ishte e mundur, apo që **B.K.**, të kthehej në Kosovë në mënyrë që ata të jenë në gjendje të jetojnë së bashku. **R.S.**, ka deklaruar se

nëse kjo nuk bëhet deri më 31 dhjetor 2008 atëherë **V.S.**, do të ndahej prej **B.K.** Ky i fundit nuk ishte në gjendje për të përmbushur këtë kusht dhe **V.S.**, jo zyrtarisht është shkurore nga **B.K.**, dhe është kthyer në shtëpinë e saj në fshatin **S.**, të Lipjanit. Megjithatë, **V.S.**, ka vazhduar të mbajë kontakte me **H.K.**, edhe pasi ajo është kthyer për të jetuar në shtëpinë e saj në fshatin **S.**, në Lipjan.

95. Në fillim të vitit 2009 viktima filloi të punojë si pastruese në një shtëpi private në Prishtinë, rr. **I.K.** Ajo ishte duke punuar nga ora 08:00 e mëngjesit deri në 16:00 pasdite. Ndonjëherë ajo largohej më herët nga puna e saj sepse kishte për tu kthyer në shtëpi.
96. Gjatë muajit shkurt 2009, marrëdhënia në mes të viktimës dhe të pandehurit u përkeqësua. Viktima ka filluar të merrte mesazheve (SMS) kërcënuese. Më 12 shkurt 2009, i pandehuri i shkroi viktimës si vijon *"I ke harruar të gjitha gjërat e mira që kam bërë për ju, në rregull është kjo. Ke harruar personin i cili të deshi me gjithë zemrën e tij, por tash do ta shohësh se çfarë do të ndodhë pa mua. Ti e din se unë mundem të ta kthej këtë sa herë që unë dua"*. Gjithashtu, më 13 shkurt 2009, 10:43 i pandehuri i shkruan viktimës *"Duhet ta dish se vetës je duke ia bërë këtë, më vonë do ta shohësh se kush jam"*.
97. Më 17 shkurt 2009, viktima me numrin e saj të telefonit **A** ka komunikuar me të pandehurin i cili ishte duke përdorur numrin **G**. Ata ranë dakord të takohen në Prishtinë në orët e pasdites. Diku rreth orës 14:00-15:00 viktima dhe i pandehuri u takuan para hyrjes së shtëpisë ku ajo ishte duke punuar. Ata kishin një bisedë të nxehtë me njëri-tjetrin. Disa minuta më vonë ata shkuan në restorant "**R.**" aty afër dhe kishin pirë kafe së bashku. Pas disa minutave, maksimum një orë, ata u larguan nga restoranti dhe shkuan në drejtim të varrezave të dëshmorëve. Ata hynë në fërgonin që i përkiste të pandehurit dhe janë nisur në drejtim të fshatit **Z.**, Komuna e Prishtinës. Ky fshat është rreth 3.3 kilometra nga Prishtina, rr. **I.K.**<sup>3</sup>
98. Në kohën kur i pandehuri dhe viktima mbërritën në fshatin **Z.**, ata filluan të diskutojnë në lidhje me marrëdhënien e tyre. Viktima ishte e gatshme të ndërpresë këtë marrëdhënie dhe të fillojë një jetë të re. I pandehuri nuk u pajtua. Duke parë se viktima kishte vendosur të vazhdojë jetën e saj pa atë, ai vendosi ta vriste. Kështu i pandehuri goditi viktimën në kokën e saj disa herë me një objekt të rëndë duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore dhe duke e privuar viktimën nga jeta e saj. Motivi i vrasjes ishte se i pandehuri nuk ka mundur të imagjinonte jetën e tij pa viktimën dhe të shihte atë duke filluar një jetë të re me dikë tjetër. Vrasja është kryer në një mënyrë të pamëshirshme dhe të dhunshme, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore viktimës, gjë që ka shkaktuar vdekjen e viktimës.

---

<sup>3</sup> Shiko <https://maps.google.com> drejtimi: Prishtinë, **I.K.**, për **Z.**, Prishtina.



99. Pas vrasjes që kishte ndodhur, i pandehuri u përpoq të fsheh identitetin e viktimës duke e marrë çantën e saj dhe duke e hedhur atë në pyll, si dhe duke e marrë xhakëtën dhe duke e hedhur atë disa metra larg.

## **VII. Kualifikimi juridik i veprës së ngarkuar**

100. Aktakuza e ngarkon të pandehurin për Vrasje të Rëndë sipas nenit 147 (5) dhe (9) të KPK-së. Ky nen thotë si vijon:

### ***Vrasje e Rëndë***

#### ***Neni 147***

*Një dënim me burgim prej së paku dhjetë vjet ose me burgim afatgjatë duhet të caktohet mbi çdo person që:*

...

*5) Privon personin tjetër nga jeta e tij apo e saj duke vepruar mizorisht e dhunshëm;*

...

*9) Privon personin tjetër nga jeta e tij apo e saj për shkak të hakmarrjes së paskrupullt apo nga motive të tjera bazë;*

101. Ne rastin aktual kryesi i veprës ka vepruar pamëshirshëm dhe dhunshëm sepse ai vazhdimisht e ka goditur viktimën ne koke dhe trup dhe me një mjet te forte duke I shkaktuar asaj lëndime te renda trupore, lëndime tjera penetruese dhe prerëse, hematoma ne pjese te ndryshme te trupit, fraktura ne kafke si dhe lëndime ne trurin e saj e kështu e ka privuar viktimën nga jeta e saj. Viktima ka pasur një vdekje te dhimbshme. Është e qarte se kjo vrasje është kryer ne mënyre te pamëshirshme dhe te dhunshme. Prandaj ky element rendues ne rastin konkret është konsumuar.

102. Me tutje, kryesi i veprës e ka kryer këtë vepër për motive te ulëta. I pandehuri ka pasur një marrëdhënie te gjate me gruan e e djalit te vëllait te tij e cila ka vendosur te ndahet prej tij dhe te filloje me një jete te re. I pandehuri duke u bazuar ne motive dhe hakmarrje te paskrupullt e ka privuar viktimën nga jeta e saj. Ai nuk ka mundur ta imagjinoje viktimën qe ajo te filloje një jete te re edhe pse ky ishte vullneti i viktimës. Prandaj, elementi I dyte rendues gjithashtu është plotësuar.

## **VIII. Dënimi:**

103. Në mënyre qe te shqiptohet dënimi për të Pandehurin, sipas Nenit 64 te KPK, gjykata duhet te shqiptoje dënimin Brenda limiteve te parapara me ligj. Neni 147 i KPK përcakton se për Vrasje te Rende ‘*Dënimi me burgim prej se paku dhjete vjet apo burgim te gjate do te shqiptohet*’. Kështu qe sipas dispozitave te KPK (2004) dënimi minimal për veprën penale Vrasje e Rende është 10 vjet dhe maksimumi është 20 vjet siç është përshtuar ne Nenin 38 (1) te KPK; Mundësia tjetër është burgim i gjate kohor qe lëvizte prej 21 deri ne 40 vjet siç përshtuhet ne Nenin 37(2) te te njëjtit Kod.

104.Me 1 Janar 2013 Kodi Penal i Kosovës ka hyre ne fuqi. Neni 179 i Kodit te Ri Penal te Republikës për veprën penale Vrasje e Rende ka përcaktuar dënimin minimal prej 10 vjet deri ne 25 vjet siç është përshkruar ne Nenin 45(1) me alternative burgim te përjetshëm.

105.Gjykata konkludon se Kodi Penal i Kosovës (2004) është legjislatura me e favorshme e aplikueshme ne këtë rast. Duke i konsideruar rrethanat lehtësuese dhe renduese, siç është përshkruar me poshtë, trupi gjykues ka arritur ne përfundim se duke u bazuar ne Kodin e vjetër te KPK vetëm burgimi afatgjate prej 22 vjetëve është proporcional me gravitetin e veprës penale. Duke i konsideruar saktësisht te njëjtat rrethana lehtësuese dhe renduese por sipas ligjit te ri penal dënimi adekuat do te ishte i njëjtë.

106.Gjykata ka konkluduar se dënimi prej 22 vjet burgim është proporcional me gravitetin e veprës, sjelljen dhe rrethanat e kryesit te veprës. Rrethanat ne vijim jane marre ne konsiderate si rrethana renduese ne shqiptimin e dënimit ndaj te pandehurit;

- a. Viktima është vrare ne mënyre te pamëshirshme dhe te dhunshme qe ka quar ne vdekje te dhimbshme dhe deformimit te trupit te viktimës.
- b. I Pandehuri dhe viktima ka pasur një marrëdhënie të diskutueshme dashurie me një anëtar te familjes.
- c. Viktima ka qene një vajze e re dhe ajo e ka pasur jetën e saj para veti.

107.Rrethanat ne vijim janë marre ne konsiderate si rrethana lehtësueses ne shqiptimin e dënimit ndaj te pandehurit:

- Gjykata ka vendosur te marre ne konsiderate rrethanën lehtësuese faktin se i pandehuri ka kaluar një kohe te gjate ne paraburgim. Kështu qe, gjykata ne emër te shtetit si këshille për shkeljen e te Drejtave e tij Njerëzore ka vendosur te shqiptoje një dënim me te lehte ne rastin konkret.
- I pandehuri nuk ka histori te kaluar penale.
- I pandehuri është i martuar dhe ai ka fëmije si dhe prindër te vjetër për te cilët ai duhet te kujdeset.

## **IX. Shpenzimet e Procedurës Penale**

108.Gjykata ka vendosur te urdhëroje te pandehurin te paguaj shpenzimet e procedurës ne shume prej 100 euro si nje shume te përbashkët. Kjo nuk është e shumta e tere e procedurave gjyqësore por sipas nenit 102(4) te KPPK ka vendosur qe pjesërisht ta liroje te pandehurin nga shpenzimet e procedurave penale sepse një pagese me e madhe do ta keqësonte ndihmën e familjes se te pandehurit. Sipas deklaratave te dhëna para gjykatës nuk është duke punuar asnjë anëtar i familjes se tij. Babai dhe nena e te pandehurit

marrin një shume te vogël te pensionit, gruaja e te pandehurit është amvise dhe fëmijët e tij janë te vegjël.

#### **X. Kërkesa pasurore juridike**

109. Meqë informatat e mbledhura ne procedura penale nuk afrojnë baza te besueshme ose për një çmim komplet apo te pjesshëm, gjykata sipas Nenit 112(2) te KPPK ka vendosur te udhëzoje palën e dëmtuar se ai mund te beje kërkesë kompensimi prone ne padi civile.

#### **XI. Konkludimi:**

110. Pas shtjellimit të kujdesshëm të të gjitha provave të kësaj lënde dhe pas dëgjimit të të gjithë dëshmitarëve të propozuar trupi gjykues ka konkluduar se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale siç është akuzuar në aktakuzë. Prandaj, gjykata ka vendosur si ne dispozitiv.

**Arkadiusz Sedek**  
**Kryetar i Trupit Gjykues i EULEX-it**

**Nora Bllaca,**  
**Gjyqtare e Kosovës**

**Willem Brower,**  
**Gjyqtar i EULEX -it**

**Natasa Malesevic**  
**Procesmbajtëse**

**KËSHILLË LIGJORE:** Personat e autorizuar ( I pandehuri, prokurori dhe pala e dëmtuar) mund te parashetrojnë ankese kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Apelit përmes kësaj gjykate. Ankesa mund te parashetrohet brenda pesëmbëdhjete (15) ditëve prej ditës se dorëzimit të kopjes së këtij aktgjykimi.